Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve, të njohura edhe si “Rregullat Nelson Mandela”, thonë se qëllimi kryesor i dënimit me burgim është mbrojtja e shoqërisë nga krimi dhe zvogëlimi i recidivizmit, dhe se këto qëllime mund të arrihen nëse periudha e burgimit shfrytëzohet për ta përgatitur, për aq sa është e mundur, ri-integritin e personave të dënuar në shoqëri përmes trajtimit të drejtë dhe me respekt gjatë kohës së burgimit<sup>1</sup>. Prandaj, sistemet juridike bashkëkohore janë të ndërtuara mbi idenë se qëllimi i ekzekutimit të sanksioneve penale nuk është (ose të paktën nuk është ekskluzivisht) ndëshkimi i personit të dënuar, por është promovimi i rehabilitimit social të tij/saj dhe i jetesës me respekt për ligjin pas lirimit.

Kështu, legjislacioni në shumë vende parasheh masa për të mundësuar kthimin e sigurt dhe gradual të burgosurve në komunitetet e tyre përkatëse, duke filluar nga pjesëmarrja në aktivitete arsimore dhe të punës (përfshirë jashtë ambienteve të burgut) deri te lirimi me kusht ose lirimi i mëhershëm.

Në Rekomandimin e tij (2003)22, Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës e përshkruan lirimin me kusht si “... një nga mjetet më efektive dhe konstruktive për parandalimin e përsëritjes së veprës dhe promovimin e ri-sistemimit, duke i ofruar të burgosurit një ri-integrit të planifikuar, të ndihmuar dhe të mbikëqyrur në komunitet”<sup>2</sup>. Kështu, lirimi me kusht synon ta mbrojë shoqërinë duke promovuar një kthim të sigurt, gradual dhe të mbikëqyrur të dënuarit në komunitet para përfundimit të dënimit.

Ankesat e përsëritura nga të burgosurit në Kosovë për keqmenaxhim, trajtim preferencial dhe korrupsion në procesin e lirimit me kusht kanë bërë që Njësia Korrektuese e Misionit (NJK) ta shqyrtojë këtë çështje më nga afër. Hulumtimet e kaluara të kryera nga Misioni mbi situatën specifike të grave dhe vajzave në sistemin korrektues të Kosovës treguan se pavarësisht nga niveli i tyre kryesisht i ulët i rrezikut për përsëritje të veprës penale, të burgosurave rrallë u është dhënë lirimi me kusht.

Ky raport synon të ofrojë një vlerësim paraprak të gjendjes aktuale sa i përket zbatimit të lirimit me kusht në Kosovë, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare si dhe kornizën ligjore vendore. Pas përshkrimit të metodologjisë së përdorur, ky raport ofron një pasqyrë të standardeve dhe detyrimeve ndërkombëtare përkatëse. Raporti vazhdon me një vlerësim të kornizës ligjore në Kosovë dhe të zbatimit të saj dhe përfundon me një listë të rekomandimeve specifike.

1 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve (Rregullat Nelson Mandela), Rregulla 4/1, 8 janar 2016, A/RES/70/175, <https://www.refworld.org/docid/5698a3a44.html> (qasur më 3 mars 2023).

2 Këshilli i Evropës: Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec(2003)22 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për Lirimin me Kusht (lirimi me kusht), 24 shtator 2003, Rec(2003)22, <https://rm.coe.int/16800ccb5d> (qasur më 2 mars 2023).



## 2. METODOLOGJIA

Gjatë periudhës mars – shtator 2022, EULEX-i ka mbledhur të dhëna dhe ka kryer vizita monitoruese në gjashtë institucione të SHKK-së. NJK-ja ka zgjedhur institucionet që kanë numër të madh të kërkesave vjetore për lirim me kusht, siç janë QK Dubravë, QK Smrekovicë, si dhe institucionet që kanë grupe që përbëhen prej kryerësve që janë në numër të vogël, grupe këto të përbëra prej të burgosurve nga komunitete të ndryshme, grave të burgosura, të burgosur të mitur dhe të burgosur me rrezikshmëri të lartë [Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan (QKM), Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan (QKF), Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë (QP) dhe Burgu i Sigurisë së Lartë në Podujevë (BSL)].

Gjatë vizitave fillestare, EULEX-i zhvilloi intervista me stafin e përfshirë në këtë proces, kryesisht punëtorë socialë dhe zyrtarë ligjorë, në mënyrë që të kishte një pasqyrë të gjithmbarshme të gjendjes së përgjithshme të procesit të lirimit me kusht. Gjithashtu, NJK-ja kërkoi nga këto institucione që ta ofronin numrin e kërkesave të vitit 2021 si dhe rezultatit e tyre. Numri i përgjithshëm i kërkesave për atë vit ishte 705, 207 prej të cilave ishin aprovuar, kurse 454 ishin refuzuar (tabela 1).

Tabela 1. Kërkesat dhe vendimet për lirim me kusht në vitin 2021

Institucioni	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Lirimi me kusht i aprovuar	Lirimi me kusht i refuzuar
QK Dubravë	436 (100%)	131 (30%)	305 (70%)
QK Smrekovicë	188 (100%)	59 (31,3%)	129 (68,7%)
BSL Podujevë	25 (100%)	0	25 (100%)
QP Mitrovicë	26 (100%)	9 (34,6%)	17 (65,4%)
QKF Lipjan	25 (100%)	8 (32%)	17 (68%)
QKM Lipjan	5 (100%)	0	5 (100%)
Gjithsej	705 (100%)	207 (29,3%)	498 (70,7%)

Shembulli i QKF-së dhe QKM-së në Lipjan i ilustron më tej të dhënat e tabelës:

Prej 25 kërkesave në QKF, janë aprovuar tetë. Dy kërkesat të cilat janë aprovuar me parashtrimin e parë kishin të bënin me të burgosur të cilët kishin kryer vepra të vjedhjes dhe lëndimeve trupore të lehta. Të dyja rastet kishin dënime të shkurta prej një viti ose më pak. Gjashtë kërkesat tjera janë aprovuar vetëm pas parashtrimit të kërkesave për herë të katërt deri në të gjashtë. Këto kishin të bënin me të burgosur që kishin kryer vepra të rënda si vrasje e rëndë, trafikim të njerëzve, ngacmim dhe mashtrim.

Një nga arsyet e dhëna për 17 refuzimet ishte se ‘pjesa e mbetur e dënimit [ishte] shumë e gjatë’. Të gjitha rastet e tjera, përkundër vlerësimeve pozitive nga stafi i burgut, janë refuzuar nga Paneli për Lirim me Kusht (PLK) me arsyetimin se ‘niveli i nevojshëm i risocializimit nuk është arritur’. Legjitimiteti ose mungesa e tij në këto arsyetime do të shpjegohet në kapitujt në vijim.

Pas vizitave fillestare në lidhje me lirim me kusht në institucionet e SHKK-së, EULEX-i kërkoi dosje të rasteve të përzgjedhura në mënyrë rastësore duke përfshirë raste të refuzuara dhe të aprovuara. Në total, Misioni i shqyrtoi 22 raste individuale (tabela 2).

Tabela 2. Rastet e monitoruara individualisht sipas institucionit

Institucioni	Rastet e monitoruara	Lirimi me kusht i aprovuar	Lirimi me kusht i refuzuar	Kërkesa e parë	Kërkesa e dytë apo pas disa herë
QK Dubravë	2	2	0	0	2
QK Smrekovicë	4	4	0	0	4
BSL Podujevë	3	0	3	1	2
QP Mitrovicë	3	2	1	0	3
QKF Lipjan	6	5	1	1	5
QKM Lipjan	4	0	4	0	4
Gjithsej	22	13	9	2	20

Gjatë shqyrtimit të këtyre rasteve, u identifikuan kriteret e mëposhtme për krahasimin e kërkesave:

- Informacioni i historikut për secilin parashtrues të kërkesës (gjinia, vendimi përfundimtar i gjykatës, kohëzgjatja e dënimit, kohëzgjatja e mbetur e dënimit nëse aprovohet lirimi me kusht).
- Numri i kërkesave të secilit parashtrues të kërkesës.
- Numri i kërkesave para aprovimit të lirimimit me kusht.
- Cilësia e kërkesave bazuar në kriteret e parashtrimit të dosjes për lirim me kusht, siç përcaktohet në Rregulloren e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)<sup>3</sup>.
- Arsytet e refuzimit të kërkesave.
- Arsytet e aprovimit të kërkesave.

Bazuar në këto kriteret, ekspertët e EULEX-it i krahasuan kërkesat të cilat ishin refuzuar me ato të aprovuara për t'i identifikuar shkaqet për vendimet e ndryshme të nxjerra nga Paneli për Lirim me Kusht (PLK). Në rastet e të burgosurve që parashtronin disa herë kërkesa para se t'u aprovohej lirimi me kusht, ekspertët krahasuan kërkesën e fundit të suksesshme me atë të mëparshmen për të gjetur dallimet midis kërkesave të cilat ndoshta e kishin shtyrë panelin të vendoste ndryshe.

<sup>3</sup> Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht, neni 18, Parashtrimi i dosjes në Zyrën e Panelit për Lirim me Kusht, Nr. 01/39, 22 shkurt 2013, [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/82171\\_Rregullorja\\_nr\\_39\\_mbi\\_Organizimin\\_dhe\\_Funksionimin\\_e\\_Panelit\\_me\\_Lirimi\\_me\\_Kusht.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/82171_Rregullorja_nr_39_mbi_Organizimin_dhe_Funksionimin_e_Panelit_me_Lirimi_me_Kusht.pdf). (qasur më 3 mars 2023).

### 3. STANDARDET NDËRKOMBËTARE LIDHUR ME LIRIMIN ME KUSHT

Lirimi me kusht rregullohet në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme, por aty ku përdoret, ai është krijuar për të arritur një qëllim publik/social (zvogëlimin e kostos së masave të mbajtjes nëpër burgje për shoqërinë, dhe kufizimin e mbipopullimit nëpër burgje), dhe njëkohësisht edhe një qëllim individual (ri-integrimin në shoqëri të një individi që është i gatshëm për një ri-integrim të tillë para përfundimit të dënimit të tij/saj).

Në përgjithësi nuk ekzistojnë traktate ndërkombëtare detyruese që i referohen shprehimisht aplikimit të lirit me kusht. Megjithatë, disa instrumente ndërkombëtare dhe evropiane jodetyruese për të drejtat e njeriut përcaktojnë parime të rëndësishme për zbatimin e drejtë të lirit me kusht si dhe disa praktika të mira. Këtu përfshihen instrumentet e OKB-së si Rregullat Nelson Mandela, Rregullat e Tokios<sup>4</sup>, Rregullat e Bangkokut<sup>5</sup> dhe Rregullat e Pekinit<sup>6</sup>, si dhe instrumentet e Këshillit të Evropës si Rregullat Evropiane të Burgjeve<sup>7</sup> dhe Rekomandimi i Komitetit të Ministrave nr. (2003)22<sup>8</sup>.

Instrumentet e sipërpërmendura vlejné për të gjithë të burgosurit, me përjashtim të Rregullave të Pekinit, të cilat janë krijuar posaçërisht për të miturit, dhe Rregullave të Bangkokut, të cilat fokusohen tek kryerëset dhe të burgosurat femra.

Disa nga parimet dhe rregullat kryesore të parapara në këto instrumente në lidhje me lirim me kusht janë:

- ✓ E drejta për informim: të burgosurit duhet të informohen për mundësinë e lirit me kusht, kriteret për lirim me kusht, etj.
- ✓ Disponueshmëria: lirimi me kusht duhet të jetë i disponueshëm për të gjithë të burgosurit, përfshirë për ata që vuajnë dënim të përjetshëm.
- ✓ Perspektiva gjinore: vendimet në lidhje me lirim me kusht duhet të marrin parasysh në mënyrë të favorshme përgjegjësitë e grave të burgosura për përkujdesje, si dhe nevojat e tyre specifike për ri-integrim social.
- ✓ Mbikëqyrja: nuk duhet t'i besohet vetëm policisë; duhet të kombinohet me ndihmën sociale.
- ✓ Koha: lirimi me kusht duhet të jepet sa më parë që të jetë e mundur.
- ✓ Të miturit: lirimi me kusht duhet të përdoret 'në masën më të madhe të mundshme' dhe 'të aprovohet sa më herët që është e mundur'.

4 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Masat e mos burgimit (Rregullat e Tokios), 2 prill 1991, A/RES/45/110, <https://www.refworld.org/docid/3b00f22117.html> (qasur 3 mars 2023).

5 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për trajtimin e grave të burgosura dhe masat e mos burgimit për gratë që kryejnë vepra (Rregullat e Bangkokut), 6 tetor 2010, A/C.3/65/L.5, <https://www.refworld.org/docid/4dcb0ae2.html> (qasur më 3 mars 2023).

6 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Miturit (Rregullat e Pekinit), 29 nëntor 1985, A/RES/40/33, <https://www.refworld.org/docid/3b00f2203c.html> (qasur më 3 mars 2023).

7 Këshilli i Evropës, Rregullat Evropiane të Burgjeve, qershor 2006, <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae> (qasur më 3 mars 2023).

8 Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec. (2003)22, <https://rm.coe.int/16800ccb5d> (qasur më 2 mars 2023).

Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nr. (2003)22 (në tekstin e mëtejme Rekomandimi) i parashtron kushtet dhe kriteret për lirim me kusht. Ai përcakton se periudha minimale që duhet ta mbajnë të burgosurit përpara se të kualifikohen për lirim me kusht duhet të përcaktohet me ligj. Sapo të përfundojë kjo periudhë minimale, autoritetet përkatëse duhet të nisin procedurën e nevojshme për lirim me kusht. Kriteret që duhet t'i plotësojnë të burgosurit për t'u kualifikuar duhet të jenë të qarta dhe të sakta, por edhe 'realiste në kuptimin që ato duhet të marrin parasysh personalitetin e të burgosurve dhe rrethanat sociale dhe ekonomike si dhe disponueshmërinë e programeve të ri-sistemimit'<sup>9</sup>. As mungesa e mundësive për punë pas liritimit e as mungesa e akomodimit të rregullt nuk duhet të përbëjnë arsye për refuzimin ose shtyrjen e liritimit me kusht. Rekomandimi më tej thekson se 'është detyrë e autoriteteve që të tregojnë se një i burgosur nuk i ka përmbushur kriteret' (barra e provës)<sup>10</sup>. Së fundi, një i burgosur duhet të ketë të drejtën që përsëri të parashtrojë kërkesë për lirim me kusht në rast refuzimi.

Rekomandimi po ashtu parashih edhe garanci procedurale duke përfshirë të drejtën e të burgosurit që të dëgjohet personalisht, që të ndihmohet sipas ligjit dhe që të ketë qasje adekuate në dosjen e tij/saj. Vendimet e autoritetit përkatës duhet t'i paraqesin në formë të shkruar arsyet themelore për aprovimin ose refuzimin e liritimit me kusht. Për më tepër, në lidhje me procedurën, arsyetimin dhe zbatimin e liritimit me kusht duhet të përcaktohen procedurat e ankimit me ligj.

Rregulli 87 Nelson Mandela përcakton se gjithmonë duhet të parashihet një regjim i para-liritimit ose një lirim të mbikëqyrur në mënyrë që të sigurohet kthimi gradual i të burgosurit në jetën në shoqëri. Rregulli 63 i Bangkokut përcakton që duhet të merren parasysh karakteristikat dhe nevojat specifike të grave kryerëse të veprave dhe atyre të burgosura<sup>11</sup>. Për më tepër, ndërsa Rregullat e Tokios përshkruajnë që masat e mos-burgimit duhet të zbatohen në fazën më të hershme të mundshme<sup>12</sup>, Rregullat e Pekinit këmbëngulin që lirim me kusht duhet të përdoret sa më shpesh dhe sa më herët që të jetë e mundur për të burgosurit e mitur<sup>13</sup>.

Rregulli 30 i Burgjeve Evropiane e nënvizon rëndësinë e informimit të të burgosurve dhe familjeve të tyre për të drejtat dhe detyrat e tyre në gjuhën që ata e kuptojnë si dhe për ecurinë e rastit të tyre<sup>14</sup>. Prandaj, administrata e burgut duhet ta mbajë një dosje për këto çështje ashtu që të burgosurit të mund ta konsultojnë. Shqyrtime të veçanta zbatohen për të burgosurit që sëmuren me sëmundje të pashërueshme dhe për këta të burgosur mund të ketë nevojë që të merret një vendim nëse ata duhen liruar *para kohe* nga dënimi<sup>15</sup>.

9 Këshilli i Evropës, Rekomandimi Rec(2003)22.

10 Po aty.

11 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rregullat e Bangkokut, faqe 19.

12 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rregullat e Tokios, faqe 4.

13 Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Rregullat e Pekinit, faqe 16.

14 Këshilli i Evropës, Rregullat Evropiane të Burgjeve, faqe 16.

15 Po aty, faqe 68.

## 4. GJETJET

### 4.1 Korniza ligjore

Dy instrumentet ligjore që rregullojnë lirimin me kusht në Kosovë janë Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>16</sup> (LESP) dhe Rregullorja e KGJK-së për Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht (në tekstin e mëtejme Rregullorja)<sup>17</sup>.

Të dyja këto instrumente e pranojnë se qëllimi i ekzekutimit të sanksioneve penale është rehabilitimi dhe risocializimi i personave të dënuar. Në përputhje me Rregullat Nelson Mandela, ato e promovojnë një kthim gradual të personave të dënuar në shoqëri duke e paraparë të drejtën për kërkimin e lirit me kusht para përfundimit të dënimit të shqiptuar.

#### *Kriteret për lirim me kusht<sup>18</sup>*

Kriteret për lirim me kusht janë të njëjta për burra dhe për gra. Kriteret për të miturit përfshijnë mundësinë e lirit pas mbajtjes së një të tretës së dënimit, pavarësisht kohëzgjatjes së dënimit. Kjo rrjedh nga parimi i vendosur nga Rregullat e Pekinit, që në rastin e të miturve, privimi nga liria duhet të jetë sa më i shkurtë që është e mundur dhe se lirim me kusht duhet të përdoret në masën më të madhe të mundshme dhe të jepet sa më herët që është e duhur.

Të rriturit që janë dënuar me më shumë se pesë vjet burgim duhet të mbajnë dy të tretat e dënimit, ndërsa ata që janë dënuar me burgim deri në pesë vjet duhet të mbajnë gjysmën e dënimit. Personat që janë dënuar me burgim të përjetshëm duhet të vuajnë të paktën 30 vjet për t'u kualifikuar për lirim me kusht sipas Kodit Penal.

Kriteret për lirim me kusht të përcaktuara nga ligji në Kosovë në përgjithësi janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përfshirë edhe mundësinë e lirit me kusht për personat e dënuar me burgim të përjetshëm, siç kërkohet nga Rregullat Nelson Mandela. Përcaktimi i Rekomandimit nr. (2003)22 të Komitetit të Ministrave që kriteret për lirim me kusht duhet të marrin parasysh personalitetin dhe rrethanat sociale dhe ekonomike të burgosurve, si dhe disponueshmërinë e programeve të ri-sistemimit është i pasqyruar në legjislacionin e Kosovës. Megjithatë, Rregullorja nuk përfshinë dispozita që në mënyrë të favorshme marrin parasysh përgjegjësitë e grave të burgosura për përkujdesje apo nevojat e tyre specifike për ri-integrim social.

Për më tepër, legjislacioni i Kosovës për lirim me kusht nuk përmend në mënyrë specifike trajtimin e veçantë që duhet të kenë të burgosurit e mitur siç kërkohet në Rregullat e Pekinit (shih më lart).

16 Kuvendi i Kosovës, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligji Nr. 08/L-132, 14 korrik 2022, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61303> (qasur më 3 mars 2023).

17 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht, 22 shkurt 2013.

18 Lirimi me kusht në Kodin Penal të Kosovës, Kodi nr. 06/L-074, 14 janar 2019, neni 90, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf> (qasur më 20 janar 2023) dhe në Kodin e Drejtësisë për të Miturit, Kodi Nr. 06/L-006, 18 tetor 2018, Neni 36, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18019> (qasur më 20 dhjetor 2022).

## *E drejta për informim*

E drejta për informim është e theksuar shprehimisht në Rregulloren që përcakton se personi dënuar ka të drejtë që kurdo pas fillimit të ekzekutimit të dënimit të kërkojë informacion nga institucioni korrektues për të drejtat, kushtet dhe procedurat që lidhen me lirim me kusht (neni 15). Për më tepër, në nen ceket se ‘60 ditë përpara se një kërkesë e pranueshme të mund t’i drejtohet Panelit, Drejtori i institucionit korrektues do t’i japë të dënuarit një njoftim me shkrim me këshillën se ai ose ajo ka të drejtë të kërkojë lirim me kusht dhe se nëse ai ose ajo parashtron kërkesë për lirim me kusht, kërkesa do të shqyrtohet nga Paneli.’

## *Fillimi i procedurës*

Procedura për lirim me kusht fillon me parashtrimin e kërkesës nga i burgosuri (apo avokati i tij/saj ose drejtori i institucionit korrektues) pranë Panelit përmes institucionit korrektues në të cilin i burgosuri mban dënimin. Kërkesa mund të shoqërohet me një deklaratë me shkrim ku përshkruhen pikëpamjet e të burgosurit për veprën e tij/saj penale, mënyrën pozitive në të cilën burgu e ka ndryshuar atë dhe planet e tij/saj për të ardhmen<sup>19</sup>.

Pas parashtrimit të kërkesës, drejtori i institucionit korrektues kërkon nga Shërbimi Sprovues i Kosovës (SHSK) që ta vizitojë të burgosurin dhe të nënshkruajë marrëveshje për mbikëqyrje pas lirimimit me kusht. Pas parashtrimit të kërkesës, drejtori i dërgon PLK-së një kopje të dosjes personale të personit të dënuar dhe një raport<sup>20</sup> të përgatitur nga një ekip profesional i institucionit korrektues.

## *Përbërja e Panelit për Lirim me Kusht*

Ligji i mëparshëm për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP)<sup>21</sup> përcaktonte që PLK-ja duhet të përbëhej nga tre anëtarë: një gjyqtar nga Gjykata Supreme, një gjyqtar nga Gjykata e Apelit dhe një gjyqtar nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Ligji i ri për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>22</sup> (LESP) parasheh zëvendësimin e gjyqtarit të Gjykatës Themelore me një zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë<sup>23</sup>.

19 Po aty, neni 17.

20 Raporti përmban informata për llojin e veprës penale të kryer; qëndrimin ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së viktimës; krimet e kryera më parë; rrethanat familjare të tij/saj dhe e kaluara sociale; gjendjen fizike dhe psikologjike, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut sa herë që konsiderohet e nevojshme nga një psikiatër ose psikolog; sjelljen në institucionin korrektues dhe suksesin e arritur në shmangien e faktorëve të veprës penale; planet pas lirimimit; mbështetjen që mund të ofrohet pas lirimimit; dhe çdo rrethanë që tregon se ai nuk do të kryejë vepër penale të re.

21 Ligji Nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Nr. 15, 11 maj 2017, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/2A05EAD6-2F58-40E7-8635-06ACA106323B.pdf>. (qasur më 3 mars 2023).

22 Kuvendi i Kosovës, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligji Nr. 08/L-132, Nr. 21, 10 gusht 2022, <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/09E32514-A9C8-40D2-BCFB-835704F8398A.pdf>. (qasur më 3 mars 2023).

23 Neni i ndryshuar 122, paragrafi 2 i LESP-së dhe neni 117, paragrafi 1 i LESP-së.

## *Procesi i vendimmarrjes për lirim me kusht*

PLK-ja mund ta aprovoj ose refuzoj kërkesën për lirim me kusht. Në rast se Paneli vlerëson se nevojiten informacione shtesë për marrjen e vendimit, vendimi mund të shtyhet për 30 ditë.

Nëse PLK-ja e refuzon kërkesën, si Rregullorja ashtu edhe LESP kanë përcaktuar se vendimet e Panelit janë përfundimtare dhe nuk mund të ankimohen. Megjithatë, kjo ndryshoi në Ligjin e ri për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale: vendimi mund të ankimohet si dhe Paneli duhet të arsyetojë refuzimin: ‘Kur lirim me kusht refuzohet, vendimi i Panelit për Lirim me Kusht duhet të përmbajë arsyetimin e refuzimit’ (neni 117/7). ‘Pala e pakënaqur me vendimin e Panelit për Lirim me Kusht ka të drejtë të ankohet ndaj vendimeve drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimit’ (neni 117/8).

Gjykata Supreme më pas do ta vërtetojë ose ndryshojë vendimin e PLK-së ose ta kthejë atë për rishqyrtim. Megjithatë, paragrafi 16 i të njëjtit nen përcakton se ‘Dispozitat e këtij neni nuk vlejné për rastet kur Paneli për Lirim me Kusht e shtynë rastin për rishqyrtim nga gjashtë (6) muaj e tutje<sup>24</sup>. Kjo çon në përfundimin se e drejta e ankesës u jepet vetëm atyre të cilëve u refuzohet kërkesa dhe për të cilët PLK-ja ka vendosur se data e rishqyrtimit të jetë nga tre deri në gjashtë muaj, por jo kur shtyrja është nga gjashtë deri në 12 muaj.

Rregullorja e shtjellon më tej procesin për rishqyrtim. Neni 34 përcakton se pasi të caktohet data e rishqyrtimit nga PLK-ja, drejtori automatikisht ia dërgon prapë dosjen e lëndës PLK-së. Gjithashtu, PLK-së i dërgohet edhe një raport i përditësuar nga ekipi profesional i burgjeve. Nëse lirim me kusht refuzohet, vendimi përmban datën kur PLK-ja mund të shqyrtojë kërkesën e personit të dënuar. Data e shqyrtimit nuk mund të jetë më e shkurtë se tre muaj dhe më e gjatë se dymbëdhjetë muaj<sup>25</sup>. Kjo mund të rezultojë në ripërpilimin e kërkesave nga stafi disa herë në vit për të njëjtin të burgosur, gjë që kërkon shumë kohë dhe punë intensive. Koha shpenzohet edhe më pa nevojë kur i burgosuri konsiderohet se i ka plotësuar kriteret për lirim me kusht në kërkesën paraprake.

Përderisa Rekomandimi i Këshillit të Evropës Rec(2003)22 përcakton se të burgosurit kanë të drejtë të ri-parashtrajnë kërkesë për lirim me kusht sapo gjendja e tyre të ndryshojë në mënyrë thelbësore në favor të tyre, kjo e drejtë nuk pasqyrohet në kornizën ligjore të Kosovës.

Vlen të përmendet se Rregullorja, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, në mënyrë shprehimore ua mohon të burgosurve të drejtën për qasje në dosjet e veta<sup>26</sup>, ndërkohë që LESP nuk e parasheh fare këtë të drejtë. Kjo është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin e Kosovës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale<sup>27</sup>, i cili e përcakton të drejtën e çdo personi për qasje në informata personale (nenet 12-14). Mohimi i qasjes gjithashtu ua pamundëson të burgosurve verifikimin e saktësisë së informacionit në dosjet personale të tyre. Kjo nga ana tjetër ndikon negativisht në transparencën e kërkesës për lirim me kusht dhe në procesin e vendimmarrjes.

24 PLK i vlerëson informatat lidhur me përmbushjen e kriterëve të parapara në nenin 14 të Rregullores së KGJK-së, përkatësisht nëse qëllimi i dënimit, risocializimit dhe ri-integritimit të personit të dënuar mund të arrihet siç kërkohet me nenin 38 të KP dhe nenet 5 dhe 6 të LESP-së, dhe vendos aprovimin ose jo të kërkesës për lirim me kusht, kurse në rast refuzimi në bazë të një vlerësimi të tillë e vendos edhe datën e rishqyrtimit.

25 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligji Nr. 08/L-132, neni 118, paragrafi 4.

26 Po aty, neni 18, paragrafi 5.

27 Kuvendi i Kosovës, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Ligji Nr. 06/L-082, 30 janar 2019, nenet 12–14, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616> (qasur më 14 mars 2023).

## 4.2 Korniza ligjore në praktikë

Nga 22 raste të shqyrtuara nga EULEX-i, 13 kërkesa për lirim me kusht ishin të aprovuara nga PLK-ja, ndërsa nëntë të refuzuara. Dy të burgosur kishin parashtruar kërkesë për herë të parë, ndërsa pjesa tjetër kishin bërë kërkesa dy ose më shumë herë. Në PLK janë dërguar nëntëmbëdhjetë kërkesa me vlerësime dhe rekomandime pozitive për lirim me kusht nga stafi i burgjeve. Tri kërkesa janë dërguar me opinion jo të favorshëm nga stafi i burgjeve<sup>28</sup>. Nga të gjitha dosjet e lëndëve të monitoruara, vetëm dy kërkesa ishin të aprovuara që në parashtrimin e parë të tyre, ndërsa pjesa tjetër ishin aprovuar pas parashtrimit të kërkesave për disa herë me radhë (tabela 3).

Në lidhje me trajtimin e të miturve, PLK-ja nuk duket se e ka aplikuar qasjen më të favorshme që kërkohet nga Rregullat e Pekinit ku EULEX-i konstatoi se asnjërit prej të miturve nga Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan nuk i ishte aprovuar lirimi me kusht edhe pas një sërë kërkesash të parashtruara. Kjo gjetje ishte shqetësuese pasi kërkimet ndërkombëtare tregojnë se burgimi i të miturve nuk është një opsion efektiv për parandalimin e recidivizmit<sup>29</sup>. Përkundrazi, burgimi i zgjatur mund të rezultojë në rritjen e sjelljes kriminale pas lirimimit.

Tabela 3. Kërkesat e aprovuara për lirim me kusht

Lirimi me kusht i aprovuar	Kërkesa për herë të parë	2-3 herë	4-6 herë
QK Dubravë	0	2	0
QK Smrekovicë	0	3	1
BSL Podujevë	0	0	0
QP Mitrovicë	0	2	0
QKF Lipjan	2	3	0
QKM Lipjan	0	0	0
Gjithsej	2	10	1

Informata më të hollësishme për vendimet e PLK-së do të jepen dhe sqarohen në paragrafin vijues.

## 4.3 Vendimet e PLK-së

Siç u përmend më sipër, nga 22 raste të shqyrtuara nga EULEX-i, 13 kërkesa për lirim me kusht ishin aprovuar (përfundimisht), ndërsa nëntë ishin refuzuar nga PLK-ja. Nga 22 rastet e monitoruara, 19 ishin dërguar në PLK me vlerësime pozitive nga institucioni, përfshirë deklaratat pozitive nga stafi i sigurisë. 19 të burgosurit ishin vlerësuar si me mundësi përgjithësisht të mira për risocializim. Ata kishin marrëdhënie të mira me familjet e tyre, kanë shprehur pendim për veprën, ishin pajtuar me familjet e viktimave dhe kishin marrë pjesë në programe rehabilitimi, ndërsa disa ishin marrë

28 Këshilli Gjyqësor i Kosovës në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Lirim me Kusht në nenin 18. përcakton se vlerësimet duhet të bëhen nga punonjësit socialë, personeli mjekësor, psikologët e burgjeve, stafi korrektues dhe drejtori i institucionit.

29 Sipas Qendrës për të Miturit dhe Drejtësinë Penale, '[një] studim nga marsi 2011 nëpërmjet Zyrës Federale të Drejtësisë për të Miturit dhe Parandalimit të Delikuencës (OJJDP) arrin në përfundimin se burgimi afatgjatë i të miturve nuk e ulë përsëritjen e veprës penale dhe në fakt mund të rrisë normat e recidivizmit për autorët e rinj të nivelit më të ulët', <https://www.cjc.org/news/blog/study-long-term-juvenile-incarceration-fails-to-decrease-reoffending-rates> (qasur më 14 mars 2023).



---

edhe me punë edukative apo të ndërtimitarisë. Disa të burgosur kanë shkuar në pushim në shtëpi pa ndonjë problem. Të tjerët nuk kishin shkelje disiplinore në të dhënat e tyre dhe u përshkruan si 'të burgosur shembull' nga stafi i SHKK-së. Me pak fjalë, shumica e dosjeve të monitoruara i plotësonin kriteret për lirim me kusht që kërkohej nga Rregullorja (neni 14). Megjithatë, vetëm dy raste ishin të parashtruesve të suksesshëm që iu ishin aprovuar kërkesat për lirim me kusht me kërkesën e parë. Edhe më e theksueshme ishte se të gjitha dosjet me vendim pozitiv kishin marrë aprovimin e tyre për lirim me kusht pas kërkesës së dytë ose të tretë, edhe pse gjendja e të burgosurve nuk kishte ndryshuar as për mirë as për keq ndërmjet kërkesave.

Arsyetimet për të gjitha vendimet negative për të gjitha kërkesat e monitoruara bazoheshin në të njëjtat nene brenda legjislacionit në fuqi, duke treguar një model të mos marrjes parasysh të vlerësimit individual të kriterëve të përshtatshmërisë së secilit të burgosur. Këto arsytetime përfshinin nenet nga Rregullorja që kishin të bënin me «Peshën e veprës» dhe «Ekzistimin e rrezikut për publikun e gjerë» ose në përgjithësi se «Nuk është arritur ende qëllimi i dënimit». Në vendimet negative janë përdorur edhe nenet e Kodit Penal të Kosovës dhe të LESP-së, të cilat *ndër të tjera* theksojnë se qëllimi i dënimit është parandalimi i recidivizmit, formulim ky i cili dukej i pavend nga kërkesat e monitoruara duke pasur parasysh se institucionet i kishin vlerësuar të burgosurit (19/22 raste) se kualifikohen për lirim me kusht, pra nuk rrezikoheshin nga recidivizmi.

Ky vlerësim përforcohet edhe më tej nga fakti se, edhe pse vlerësimet pozitive janë përmendur në arsytetime, ato nuk duket se kanë pasur ndonjë ndikim në vendimet e PLK-së. Një shembull i kësaj ishte se rregullisht përmendej pjesa e mbetur e dënimit. Kjo është një arsye e papranueshme, pasi kërkesa në radhë të parë nuk do të ishte përcjellë në PLK nëse pjesa e mbetur e dënimit do të ishte shumë e gjatë. Një arsye tjetër e zakonshme për refuzim ishte pretendimi se nuk ishte arritur qëllimi i dënimit, pa ndonjë udhëzim se si do të arrihej ai qëllim. Shqetësim i veçantë paraqitet nga konstatimi se grave dhe të miturve u refuzohej lirimi me kusht përkundër vlerësimeve të SHKK-së të cilat tregonin qartë përshtatshmërinë për lirim me kusht.

Sipas stafit të SHKK-së, këto refuzime të vazhdueshme të cilat nuk i pasqyrojnë vlerësimet e SHKK-së dhe që nuk përfshijnë arsytetime të plota dhe transparente janë frustruese dhe demotivuese si për të burgosurit ashtu edhe për stafin. Çka është edhe më keq, në disa raste PLK-ja pohoi se refuzimi ishte tërësisht i bazuar në vlerësimin negativ nga vetëm një pjesëtar i stafit të SHKK-së, duke shkaktuar kështu tensione ndërmjet të burgosurve dhe stafit të SHKK-së. Duhet të theksohet se, ndonëse të burgosurit nuk kanë të drejtë t'i lexojnë vlerësimet e bëra për ta, ata kanë qasje në vendimet e PLK-së.

Në rastet kur lirimi me kusht është aprovuar, data aktuale e lirimit ishte gjithmonë brenda disa ditëve të punës nga pranimi i vendimit. Bazuar në intervistat me stafin e SHKK-së dhe të SHSK-së, kjo ka lënë shumë pak kohë për përgatitjen e lirimit të burgosurve, meqë sidomos pas një kohe më të gjatë të burgimit, të burgosurve dhe zyrtarëve u duhet kohë për t'i organizuar aspektet e pas-burgimit ku përfshihen punësimi, të ardhurat dhe mekanizmat mbështetës varësisht prej nevojave të individit. Përveç vështirësive të SHKK-së për organizimin e takimeve me zyrtarët tjerë, të burgosurit kanë pak kohë për t'u përshtatur me idenë e jetës jashtë burgut. Hulumtimet tregojnë se përshtatja me shoqërinë pas burgimit mund të jetë sfidë, veçanërisht për të burgosurit që kanë qëndruar në burg për kohë të gjatë<sup>30</sup>, prandaj si të burgosurve ashtu edhe zyrtarëve duhet t'u jepet një kohë e mjaftueshme, për shembull një muaj, për të siguruar një periudhë të qetë tranzicioni.

---

30 Hulley, S., Crewe, B., & Wright, S. (2016). *Rishqyrtimi i problemeve të burgimit afatgjatë*. Gazeta Britanike e Kriminologjisë, 56 (4), 769-792.

---

Misioni gjithashtu mësoi se kërkesave për lirim me kusht të parashtruara në serbisht, PLK-ja u ishte përgjigjur në gjuhën shqipe. Kjo jo vetëm që krijon probleme për stafin e SHKK-së dhe të burgosurit, por edhe e shkel Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve<sup>31</sup>, i cili parasheh përdorimin e të gjitha gjuhëve zyrtare të Kosovës brenda institucioneve.

#### 4.4 Kërkesat për lirim me kusht dhe ruajtja e dosjeve nga SHKK-ja

Parashtrimi i dosjeve të lëndëve për lirim me kusht i plotësonte vetëm pjesërisht standardet e përcaktuara në Rregullore: kërkesat dhe deklaratat kanë qenë të shkruara në detaje nga stafi i institucionit, deklaratat e të burgosurve kanë qenë të përfshira në dosje, deklaratat e sigurisë janë dhënë nga zyrtarët e sigurisë së burgut, si dhe planet personale të burgosurve si për lirim me kusht ashtu edhe për periudhën pas lirimit kanë qenë të përfshira në dosje<sup>32</sup>. Megjithatë, deklaratat e personelit mjekësor të burgjeve si dhe deklaratat e drejtorëve të burgjeve shpesh nuk kanë qenë të përfshira në dosje. Për më tepër, disa nga dosjet nuk i përmbanin të gjitha vendimet e PLK-së dhe/ose të gjitha kërkesat e të burgosurve. Dhe e fundit, jo të gjitha dosjet kanë qenë të ruajtura në një vend dhe disa dosje ekzistonin vetëm në formë elektronike, kurse të tjera ishin të disponueshme vetëm në kopje fizike.

---

31 Kuvendi i Kosovës, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, Neni 1, Ligji Nr. 02/L-37, 27 korrik 2006, <https://www.refworld.org/docid/4ae96d832.html> (qasur më 3 mars 2023).

32 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Rregullorja për Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për Lirim me Kusht, neni 18, [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/82171\\_Rregullorja\\_nr\\_39\\_mbi\\_Organizimin\\_dhe\\_Funksionimin\\_e\\_Panelitme\\_pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/82171_Rregullorja_nr_39_mbi_Organizimin_dhe_Funksionimin_e_Panelitme_pdf). (qasur më 10 mars 2023)

## Rekomandime:

- Çdo përgjigje nga PLK-ja, qoftë pozitive apo negative, duhet të përmbajë një arsyetim të qartë i cili duhet të bazohet në vlerësimin individual të secilit parashtrues të kërkesës e jo të bazohet thjesht në aktet nënligjore. Përveç kësaj, vendimet duhet të përfshijnë rekomandime se çfarë masa mund t'i marrin të burgosurit për t'u kualifikuar për lirim me kusht. Si shembull, vendimet pozitive të PLK-së ishin të qarta dhe transparente dhe i përmbanin të gjitha aspektet e vlerësimit të një të burgosuri nga ana e SHKK-së. Kjo praktikë e mirë duhet të përdoret edhe në vendimet me përgjigje negative.
- Në rastet kur kemi një vendim me përgjigje pozitive nga PLK-ja, të burgosurve dhe zyrtarëve të SHKK-së dhe SHSK-së duhet t'u jepen së paku 30 ditë kohë për t'i kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme për lirim që pritet të bëhet dhe për të pasur kohë të mjaftueshme për shkëmbimin e informatave ndërmjet homologëve përkatës.
- Përcaktimi i Rregullave të Pekinit për t'ua lejuar të miturive lirim me kusht sa më parë që të jetë e mundur për t'i minimizuar efektet negative të burgosjes dhe rrezikun e recidivizmit duhet të përfshihet në legjislacionin përkatës të Kosovës.
- PLK-ja duhet të veprojë në përputhje me Rregullat e Bangkok-ut, pra ta marrë parasysh në mënyrë të favorshme çdo përgjegjësi të grave të burgosura për perkujdesje, si dhe nevojat e tyre specifike për ri-integrim social.
- Qëllimit të lirim me kusht duhet kushtuar më shumë vëmendje nga PLK-ja kur vendoset për lirim me kusht, veçanërisht për të burgosurit afatgjatë dhe të miturit.
- Për hir të transparencës dhe të drejtës për informim, të burgosurit duhet të lejohen që t'i lexojnë vlerësimet e kërkesave të përpiluara nga stafi i institucionit përpara se ato të dërgohen në PLK.
- Vendimet e PLK-së duhet të shkruhen në gjuhën që është përdorur edhe në kërkesë, në përputhje me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.
- Përditësimi i paraparë i Rregullores së Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Lirim me Kusht duhet ta përfshijë vlerësimin e planeve të dënimit të burgosurve si një kriter për lirim me kusht.
- SHKK-ja duhet të angazhohet për përmbushjen e standardeve të përcaktuara në Rregulloren e KGJK-së për Organizimin dhe Funksionimin e Panelit për Lirim me Kusht me rastin e dorëzimit të dosjes për lirim me kusht në PLK.
- Institucionet e SHKK-së duhet të angazhohen për menaxhimin e duhur të dosjeve për lirim me kusht për të siguruar standarde adekuate të mbajtjes së regjistrave dhe qasje në informacione gjithëpërfshirëse përgjatë gjithë procesit.

---

## 5. SHËNIME PËRMBYLLËSE

Sistemet korrektuese dhe politikat gjyqësore duhet të përqendrohen në ri-sistemimin e të burgosurve qysh në fillim të planeve të dënimit të burgosurve për mundësi të shtuar të ri-integritit në komunitet. Një ri-sistemim pozitiv ka të ngjarë t'i zvogëlojë përsëritjet e veprave, gjë që i shërben atyre që dalin nga burgimi si dhe komunitetit të gjerë. Instrumentet ndërkombëtare të drejtave të njeriut e njohin qartë rëndësinë e lirit me kusht si një mjet efektiv dhe konstruktiv për parandalimin e përsëritjes së veprës dhe për nxitjen e ri-sistemimit. Legjislacioni i Kosovës e miraton këtë bindje në parim, por kjo nuk shndërrohet në përdorim të drejtë dhe të duhur të këtij mjeti në praktikë, me mangësi serioze në zbatimin e tij, në veçanti kur bëhet fjalë për të miturit dhe gratë.

Edhe pse kriteret e kualifikimit për lirim me kusht që janë të përcaktuara me ligj në Kosovë në përgjithësi janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, kërkesat për lirim me kusht shpesh refuzohen ose aprovohen vetëm pasi ato të jenë parashtruar për disa herë me radhë, pavarësisht vlerësimeve pozitive nga stafi i burgjeve. Arsyetimet e Panelit për Lirim me Kusht bazohen kryesisht në formulimin e akteve nënligjore dhe jo në vlerësimet individuale të burgosurve. I gjithë procesi i vendimmarrjes ka mungesë të transparencës, që shtohet më tej nga mohimi i qasjes së të burgosurve në dosjet e tyre.

Përkundër përditësimit të fundit të legjislacionit të Kosovës, disa aspekte në lidhje me lirim me kusht siç edhe rekomandohet në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ende mungojnë. Megjithatë, në përgjithësi gjyqësori i njeh përfitimet e lirit me kusht dhe tani është koha që ai të inkurajohet që ta promovojë përdorimin e lirit me kusht dhe ta bëjë atë të qasshëm në praktikë për të gjithë ata që i plotësojnë kushtet.





Misija Evropske unije za vladavinu prava na Kosovu

# **Primena uslovnog otpusta na Kosovu: Nalazi i preporuke**

Mart 2022 – Septembar 2022.

Maj 2023. god.

---

# SADRŽAJ

---

1. Uvod.....	41
2. Metodologija.....	42
3. Međunarodni standardi koji se odnose na uslovni otpust.....	44
4. Nalazi.....	46
5. Zaključne napomene.....	53

---

## SPISAK SKRAĆENICA

---

<b>KC</b>	Korektivni centar
<b>JNP</b>	EULEX-ova Jedinica za nadgledanje predmeta
<b>KUO</b>	Komisija za uslovni otpust
<b>KJ</b>	EULEX-ova Korektivna jedinica
<b>PC</b>	Pritvorski centar
<b>KCŽ</b>	Korektivni centar za žene
<b>ZVB</b>	Zatvor visoke bezbednosti
<b>KCM</b>	Korektivni centar za maloletnike
<b>KSK</b>	Korektivna služba Kosova
<b>SSK</b>	Sudski savet Kosova
<b>PSK</b>	Probaciona služba Kosova
<b>ZIKS</b>	Zakon o izvršenju krivičnih sankcija
<b>ZIKS</b>	Zakon o izvršenju kaznenih sankcija
<b>MUP</b>	Ministarstvo unutrašnjih poslova

---





---

# 1. UVOD

